

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 24.06.2013

KONFERENCË PËR SHTYP

Konkluzione paraprahe mbi zhvillimin e procesit të votimit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 23 Qershorit 2013

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) u përfshi në monitorimin e procesit zgjedhor për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë dhe e shtriu monitorimin e tij mbi përgatitjen e zgjedhjeve, mbi ditën e votimit dhe mbi numërimin e votave.

KShH jep këtë konferencë për shtyp për të bërë të njohura gjetjet e deritanishme, duke u ndalur veçanërisht në gjetjet e ditës së votimit. Ne kemi monitoruar rreth **1000 QV (rreth 20% të totalit)**, të shpërndara në 9 qarqe të vendit, si në **Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Kukës¹**, dhe me rreth **50 vëzhgues po vazhdojmë monitorimin në rreth 35 VNV(40% e tyre)**. Janë monitoruar, gjithashtu, **6 QV të vendosura në institucione të posaçme, burgje dhe paraburgime**.

Stafi i KShH dhe monitoruesit tanë të mrekullueshëm, kanë kryer me sukses dhe korrektësi detyrën e tyre dhe për këtë meritojnë një falënderim të sinqertë dhe të ngrohtë. Gjithashtu një falënderim i sinqertë shkon për donatorët tanë, Ambasadën Amerikane në Shqipëri, organizatën suedeze CRD dhe Fondacioni për Shoqërinë e Hapur (Soros), të cilët me mbështetjen e tyre financiare bënë të mundur këtë monitorim.

Në shprehjen e konsideratave tona rreth këtij procesi zgjedhor do t'u referohemi standardeve të Kopenhagenit, sepse ato janë parametrat që i përkasin një shteti dhe shoqërie demokratike dhe përbëjnë bazën e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverisjeje që lind në demokraci.

- 1. Lidhur me përgatitjen e zgjedhjeve standardet e Kopenhagenit theksojnë se shtetet palë duhet të sigurojnë që ligji dhe sistemi politik vendas duhet të mundësojnë kryerjen e fushatave elektorale në një atmosferë korrekte e të lirë, në të cilën as masat administrative, as dhuna, as presioni nuk do t'i pengojnë partitë ose kandidatët që të shprehin lirisht opinionet e tyre dhe pozicionet dhe nuk do të ndalojnë zgjedhësit të njohin e të diskutojnë, ose për të dhënë votën e tyre pa frikën e persekutimit.**

Për sa më sipër, ju kujtojmë se KShH ka zhvilluar një konferencë për shtyp në datën 13 Qershor 2013 dhe në të ka trajtuar gjerësisht gjetjet e veta. Materialin mund ta gjeni në faqen zyrtare të KShH.

- 2. Lidhur me zhvillimin e procesit të votimit standardet demokratike të Kopenhagenit përcaktojnë se zgjedhjet duhet të jenë të lira, të ndershme, dhe të garantojnë votim të fshehtë. Procesi ligjor duhet të garantojë votimin e përgjithshëm dhe në kushte të**

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

barabarta për shtetasit madhorë dhe se votat duhet të numërohen dhe raportohen me ndershmëri dhe rezultatet e tyre zyrtare duhet të bëhen publike.

Duke iu referuar këtyre standardeve KShH ka konstatuar se procesi aktual i votimit është zhvilluar përgjithësisht i qetë e në përputhje me standardet e sipërsënuara dhe legjislacionin vendas, por janë evidentuar edhe shkelje, të cilat në tërësinë e tyre, nuk e kanë bërë të papranueshëm këtë proces. Më poshtë po renditim shkeljet më të rëndësishme të konstatuara nga monitorimi ynë.

Procesi ka filluar me vonesë pothuajse në 70% të qendrave të votimit të monitoruara, vonesa që kanë shkuar edhe në mbi 1 orë. Këto vonesa janë shkaktuar më së shumti nga mungesa e komisionarëve (kryesisht atyre të PR dhe LSI), ose nga mbritja e tyre me vonesë në selinë e QV përkatëse, si dhe për shkak të kryerjes me vonesë të procedurave të hapjes së votimit. Ky fenomen është hasur më shpesh në Tiranë² Gjirokastrë³, Kukës⁴ Vlorë⁵ etj.

Nuk u konstatuan probleme lidhur me listat e votimit por pati vështirësi, veçanërisht në Tiranë, për gjetjen e QV ku do të votohej, për shkak se ato ishin ndarë me fraksione dhe nuk ishin vendosur shenja orientuese, të mjaftueshme, për të orientuar qartë zgjedhësit. Megjithatë në raste sporadike rezultoi se disa persona nuk e gjetën emrin në lista dhe për këtë arsye nuk u lejuan të votonin. Ankimi në gjykatë për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës rezultoi se është përdorur pak. Në Gjykatën e Tiranës janë drejtuar 240 kërkesa dhe janë dhënë 240 vendime, ndër të cilat 8 rrëzuar, dhe 13 pushuar. Kërkesat dhe vendimet në rrethet e tjera kanë qenë shumë të pakta, konkretisht në Gjykatën e Kukësit (1 kërkesë), Fier (3 kërkesa) dhe Shkodër (10 kërkesa). Ndërsa në Gjykatën e Elbasanit janë 50 kërkesa.⁶

Nuk ka patur probleme të shumta me dokumentet e identitetit të zgjedhësve. Në disa raste ndonjë votuese femër kishte mbiemrin e vajzërisë në kartën e identitetit dhe mbiemrin e martesës në listën e zgjedhësve (QV 1991, 1573) dhe për këtë arsye ato nuk janë lejuar të votojnë. Megjithatë në disa QV ato janë lejuar të votojnë, duke krijuar kështu dy standarde të zbatimit të ligjit nga administrata zgjedhore. Gjithashtu nuk janë lejuar të votojnë as personat me dokumente identifikimi të pavlefshme, në rastet e pakta kur zgjedhësit u paraqitën me to përpara KQV.

Është konstatuar një përhapje më e gjerë e votimit familjar, konkretisht në Vlorë⁷, në Tiranë⁸, Korçë⁹, Shkodër (Koplik), në Gjirokastrë etj. Monitoruesit tanë kanë bërë vërejtje të shumta me shkrim në këtë drejtim, por komisionarët rrallë kanë reaguuar. Nga kjo rezulton se në të ardhmen duhet punuar më mirë për trajnimin e tyre në këtë aspekt dhe duhet rritur kërkimi i përgjegjësive ndaj këtij fenomeni.

² QV1489/2, 13921, 1492, 1439, 1799/1, 1910, 1869/2, 1490, 1895/2, 1906, 1425, 1789, 1730/2, 1703/2, 1888/3, 2003, 1853, 1481/1, 1683/1, 1684, 1748, 1992, 1493/1, 1528, 1991/1, 1925/1, 2984/1, 3005/1, 30231, 2995/1, 2994/1, 1489/2, 1910, 1885, 1835, 1890, 1425, 1789, 1392/1, 1703/2, 188/3, 1804/2, 1410, 1885, 1947/2, 1948,

³ QV 4252, 4251

⁴ ,QV 0652,0651,

⁵ QV4499, 44991, 4500, 45001, 4504, 4428, 44281, 4454, 4473, 4419, 44191, 4420,

⁶ mbizotërojnë kërkesat nga Paraburgimi Elbasan dhe Peqin, 27 kërkesa nga I EVP Korçë, 19 kërkesa nga IP Vlorë , ne Tiranë 86 kërkesa ngaInstitucioni 313 dhe Institution 302.

⁷ QV 45041, 4398

⁸ QV 1703/1, 1983/1, 1876/1, 1703, 1876, 4504, 2376, 2041/1, 2041/2, 2042/3

⁹ QV 3647, 3647, 3664/1, 3700/1, 3673, 3658, 3678

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me votimin e personave me aftësi të kufizuar, në shumë raste, nuk janë respektuar procedurat e parashikuara në nenin 108 të Kodi Zgjedhor. Janë vërejtur një sërë problematikash si: mosdeklarimin në librin e protokolleve të personave që kanë ndihmuar votuesit me aftësi të kufizuar; raste të ndihmës së dhënë nga komisionarët në dhomën e fshehtë; ndërsa në disa QV nuk janë lejuar personat me aftësi të kufizuar të ndihmohen nga persona të tjerë, siç parashikon ligji (QV 1994/3). Një rast flagrant shënohet në QV 1869/1 ku një person me aftësi të kufizuara mendore është ndihmuar nga një zgjedhës tjetër, i cili ka votuar pa pyetur votuesin. Shkelje të tilla janë vërejtur në Korçe, Tiranë, Elbasan etj.

Përshtatshmëria e ambienteve për personat me aftësi të kufizuar. Në pjesën më të madhe të QV-ve të monitoruara dhe ku votonin zgjedhës me aftësi të kufizuar, nuk ishin instaluar rampa ose ashensorë, ndonëse disa QV ndodheshin në katin e dytë, ose të tretë, duke mos u krijuar kështu mundësinë e aksesit personave me paaftësi për të lëvizur vetë. Kjo mangësi u vërejt gjerësisht në Tiranë¹⁰, por edhe në qarqe të tjera të monitoruara prej nesh.

Personave të verbër nuk ju dha mundësia e përdorimit të fletëve të votimit të posaçme, siç është parashikuara shprehimisht nga neni 108/6 i KZ, duke shkaktuar në këtë mënyrë cenimin e fshehtësisë së votës për ta edhe në rastet kur kanë votuar me ndihmën e ndonjë zgjedhësi tjetër.

Qetësia dhe rregullshmëria e procesit të votimit dhe roli i policisë (incidentet, etj). Në shumicën e QV-ve votimi ka vijuar i qetë dhe pa flukse të mëdha të personave që prisnin të votonin. Megjithatë në këto zgjedhje ndodhën edhe disa incidente të rënda, në afërsi të QV-ve, ose brenda tyre, si rasti i vrasjes së simpatizantit të LSI dhe plagosjes së kandidatit të PD-së në Laç, goditja e komisionarit të PS në Kamëz, incidenti me kryetarin e Bashkisë së Kamzës dhe komisionarin e KZAZ-së në Bathore, të Tiranës; goditja e vëzhguesit në qytetin e Korçës nga një prej komisionarëve; plagosja e tre simpatizantëve të Partisë socialiste në Laprakë të Tiranës, etj.

Gjithashtu në mjediset jashtë QV është konstatuar një fluks i madh i personave që kryenin detyra në emër të subjekteve politike, të cilët kanë shkaktuar rëndim të qarkullimit dhe kanë tensionuar atmosferën pranë QV.

Nuk kanë munguar dhe raste të presionit mbi zgjedhësit, komisionerët, mediet dhe monitoruesit. Në ndonjë rast vëzhgues të subjekteve zgjedhore kanë orientuar zgjedhësit lidhur me procedurat që kryhen nga zgjedhësit kur i drejtohet komisionit për të votuar; kanë ndërhyrë duke u treguar zgjedhësve si të palosin fletën e votimit, ose si ta plotësojnë atë(QV 1711/1). Është vënë re gjithashtu se disa vëzhgues të subjekteve zgjedhore si dhe militantë të subjekteve zgjedhore kanë ushtruar presion mbi zgjedhësit e pranishëm, si në QV 1803/1, 1960/2, 2041/1. Presion mbi zgjedhësit është vënë re dhe nga kandidatët për deputet i PD-së në disa QV të Korçës(nr. 3673), si dhe nga kryetari i Bashkisë Kamëz në QV 1573, nr. 4497/2 etj.

Në disa raste sporadike ka pasur fluks votuesish dhe konfuzion brenda qendrës së votimit, ose dhe raste konfliktesh, si në Elbasan¹¹, Tiranë¹² në Vlorë (4504, 45041), Burgu 302, në Gjirokastrë (4265) etj.

¹⁰ QV Nr. 1900, 1808, 1808/1, 1694, 1683, 1685, 1685/1, 1810, 1810/1, 1812, 1871, 1871/1, 1871/2, 1872, 1872/1, 1872/2, 1869/2, 1891, 1869/2, 2003, 1747

¹¹ QV 356, 2356/1, 2357, 2335/1, 2339/1, 2339, 2327, 2305, 2306

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me respektimin e fshehtësisë së votës është konstatuar se në disa QV nuk janë ndjekur rregullat për të garantuar fshehtësinë e votës. Kjo ka ndodhur për shkak të vendosjes së gabuar të dhomës së votimit, si në Shkodër QV. Nr. 313/1, 295, Tiranë QV 1708; Vlorë QV 4405, 2376; qëndrimin të gabuar të ndonjë komisioneri pranë dhomës së fshehtësisë, etj. Në disa raste u konstatua **fotografimi i votës me telefonat celularë, si** në Tiranë QV 1711/1, 1714, 1947, 2008, 1707, 1908, Korçë QV 3673, Vlorë QV 4510/1¹³. Në të gjitha këto raste komisionet e QV përveçse e kanë konsideruar fletën e votimit si të dëmtuar, e kanë pajisur personin edhe me një fletë tjetër votimi, duke mbajtur shënim emrin e zgjedhësit përkatës, që shkeli ligjin. Në ndonjë rast tjetër sporadik komisionet nuk kanë kryer asnjë veprim dhe e kanë lejuar zgjedhësin të votojë me fletën e votimit që kanë fotografuar (QV 2008). Një shembull i tillë i shëmtuar e tepër flagrant ishte ai i ministrit aktual të brendshëm dhe njëkohësisht kandidat për deputet në këto zgjedhje.

Një rast tjetër i identifikuar është ai kur votuesi ka bërë publike fletën e votimit të plotësuar përpara se ta paloste dh eta hidhte në kutinë e votimit. Ky rast ka ndodhur në komunën Bërdicë (QV 0217).

3. Standardet e Kopenhagenit përcaktojnë se lidhur me organet e administrimit zgjedhor dhe procedurat zgjedhore shtetet palë duhet të garantojnë procedura zgjedhore korrekte, që mundësojnë respektimin e zgjedhje të lira, të drejta e të fshehta.

Në këtë kuadër merr rëndësi ngritja e organeve të administrimit zgjedhor dhe trajnimi i tyre, sigurimi i bazës materiale dhe mjediseve të përshtatshme. Nga monitorimi rezulton se në të gjitha KZAZ-të u ngritën rregullisht KQV-të, megjithatë është shqetësues fakti që ka pasur zëvendësime të anëtarëve të këtyre organeve në vazhdimësi, të cilat kanë ndodhur për shkak të kërkesave të subjekteve zgjedhore. Në disa KZAZ si ato me nr 50, 81, 82, 83, 84, 85, etj, janë vërejtur edhe mungesa në radhët e anëtarëve të KQV-ve deri në ditën e votimit. Shumica e komisionerëve ishin trajnuar nga KQZ-ja dhe trajnime kishin organizuar edhe vetë partitë politike të përfshira në zgjedhje. Megjithatë, nuk kanë munguar edhe KZAZ ku trajnimi nuk ishte realizuar plotësisht, si në ato me nr. 30, 37, 38, 82, 83, 84 dhe 85.

Dorëzimi i materialeve zgjedhore realizoi se u krye në datën 22 Qershor 2013 në të gjitha KZAZ-të, por shpërndarja e materialeve nga KZAZ-të drejt KQV-ve ka pasur probleme dhe vonesa në 55% të KZAZ-ve të monitoruara. Nuk kanë munguar dhe rastet kur materiali i mbritur pranë KQV-ve kishte pasaktësi ose mungesa, ngatërresa të kapakëve të kutive të materialeve të votimit dhe fletëve të votimit, janë vendosur vulat gabim në kutinë e votimit ose probleme të tjera me kodet e sigurisë. Këto probleme janë konstatuar në Korçë QV 3660, në Tiranë QV 1493, 1416, 1711/1, 1947/2, 1948, 1890 etj, por fatmirësisht ato u zgjidhën, sipas ligjit, nga KZAZ-të ose KQZ-ja gjatë ditës së votimit dhe nuk u bënë shkak për të penguar zhvillimin e zgjedhjeve.

Funksionimi i KQV-ve, në pjesën më të madhe të atyre që kemi monitoruar, ka ecur i qetë dhe në përputhje me ligjin. Megjithatë janë vënë re disa problematika. Nga monitorimi i procesit të votimit rezulton se në shumicën e QV-ve, komisionerët nuk kanë pasur informacionin e duhur rreth kompetencave të tyre dhe procedurat që duhet të ndiqeshin ditën e votimit, duke lënë të kuptohet se

¹² QV 1982/2, 1803, 1757/1, 1853, 18291, 1682/1, 1682/2, 1854/2,

¹³ Vezhguesja e KSHH-së bëri vërejtje por nuk u pranua nga Komisioni

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

trajnimi i tyre ka pasur probleme, ose komisionerët që u zëvendësuan ditët e fundit nuk përfituan fare trajnim.

Nga monitorimi, rezultoi se në shumicën e QV-ve ambientet, nga pikëpamja fizike, ishin të përshtatshme dhe me hapësirën e duhur për zhvillimin e votimit. Skema e miratuar nga KQZ, që tregonte mënyrën e sistemimit të pajisjeve në QV u respektua përgjithësisht, megjithatë në disa QV u konstatuan probleme. Disa QV kishin në dispozicion hapësirë tepër të vogël, ose nuk respektuan skemën e sugjeruar nga KQZ dhe për pasojë krijuan konfuzion gjatë votimit, krijuan kushte për cenim të fshehtësisë së votës, ose pengim të vëzhguesve për të kryer mirë detyrën e tyre, si p.sh (QV 2013/1, 2013/3, 1911/1).

Ka pasur edhe raste të pezullimit të procesit të votimit, të cilat kanë ardhur për shkak të mungesës së bazës materiale, për shkak të gabimeve të bëra nga komisioni gjatë zbatimit të procedurave të votimit, debateve midis anëtarëve të komisionit, ndërprerja në mënyrë të pamotivuar etj, si në Korçë QV 3660, në Tiranë QV1493/1, 1416, 1928/1, 1839, në Shkodër QV 295, etj.

Përsa i përket zbatimit me përpikëri të procedurave ligjore të votimi nga komisionet, rezultoi se kryesisht në të gjitha QV-të ato janë respektuar. Përgjithësisht komisionerët kanë bërë verifikime të emrit, firmosjen në listën e zgjedhësve, verifikimin e timbrosjes dhe më pas timbrosjen e zgjedhësve sipas procedurave ligjore. Përgjithësisht, në ndonjë rast sporadik, verifikimi i timbrosjes nuk është bërë rregullisht, si në Shkodër (teatri Migjeni), ose timbrosja bëhej pasi zgjedhësi kishte votuar (Komuna Aliban, Vlorë Qv 4400).

Sipas Kodit Zgjedhor, 24 orë para ditës së votimit duhet të respektohet heshtja zgjedhore, por pavarësisht nga kjo, në disa raste heshtja është thyer. Një ditë përpara votimit dhe ditën e votimit zgjedhësve u janë dërguar sms, me anë të të cilave u bëhej thirrje për votim në favor të disa subjekteve zgjedhore. Pranë disa qendrave të votimit në afërsi, nga 20 deri 150 metra, janë vënë re materiale propagandistike si flamuj, postera, ndërsa brenda QV u vu re se anëtarë të komisionit mbanin me vete materiale propagandistike si byzylykë, stilolapsa, varëse, ora, bluza me shenja ose simbole të subjekteve zgjedhore, si në Tiranë Qv 1991, në Novoselë Vlorë QV4406¹⁴.

Procedurat e mbylljes së votimit në të shumtën e qendrave të votimit është kryer në orën 19:00, normalisht dhe paqësisht, duke respektuar procedurën ligjore. Në disa QV, votimi u mbyll me vonesë për shkak të radhës së njerëzve, që ndodheshin jashtë QV në orën 19.00, të cilët sipas përcaktimit të KZ u lejuan të votonin. Vonesat u përkisnin QV 1977, 2569/1, 1714, 1966, 1418/1, etj. Transportimi i kutive me materialet zgjedhore është bërë në rregull, në pjesën më të madhe të QV-ve të monitoruara, por pati edhe ndonjë rast kur transportimi i tyre u bë me vonesë.

Numërimi i votave (Të dhëna pjesore) KShH monitoroi edhe aspekte të procesit të numërimit të votave. Na ka rezultuar se propozimet e partive politike për anëtarët e grupeve të numërimit kanë mbritur me vonesë dhe për pasojë këto organe nuk u krijuan brenda afatit të parashikuar në ligj. Mangësi u vërejtën edhe me verifikimin e dokumentacionit që duhet të plotësonin partitë politike për anëtarët e propozuar. Trajnimi zyrtar i GNV pritej të bëhej në orët e vona të natës së datës 22 Qershor 2013, por efektivisht u krye pas përfundimit të procesit të votimit.

¹⁴ Është bërë vërejtje me shkrim nga vëzhguesja jonë

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Procesi i numërimit të votave, në përgjithësi, filloi me vonesë. Në shumicën e KZAZ-ve, deri në orët e para të mëngjesit KNV kanë qenë të papërgatitura për të filluar procesin e numërimit. Përkatësisht, rezulton se ky proces nuk kishte filluar në afatet ligjore në KZAZ-te 21, 26, 29, 33, 38, 39, ndërkohë që ka filluar numërimi në orët e vona të mëngjesit në KZAZ-të nr. 20, 24, 25, 32, 36, 40, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86. Arsyet e vonesave apo mos fillimit të numërimit janë i mos mbërritja në kohë e materialeve zgjedhore nga QV-të, mos konstituimi i grupeve të numërimit në disa KZAZ, zhvillimi i trajnimit të grupeve të numërimit në orët e para të mëngjesit, mungesa e organizimit të punës dhe instalimit të pajisjeve në ambientet e numërimit, etj. Në KZAZ-te 32 dhe 49, në orët e para të mëngjesit, u morr vendimi për ndërprerjen e numërimit dhe për rifillim e numërimit në orën 10:00 për shkaqe të paqarta. KShH vlerëson se të gjitha këto problematika të konstatuara mund të shkaktojnë tejzgjatje të procedurave të numërimit, dukuri që është konstatuar edhe në vitet e kaluara.

4. Lidhur me transparencën e procesit zgjedhor standardet e Kopenhagenit përcaktojnë se shtetet pale vlerësojnë se prezenca e vëzhguesve, si të atyre të huaj apo vendas, mund ta përmirësojë procesin zgjedhor të vendit ku mbahen zgjedhjet. Ato do të bëjnë të mundur që asnjë pengesë ligjore ose administrative të mos kufizojë aksesin e mjeteve të informacionit, mbi baza jodiskriminuese, tek të gjitha grupet politike dhe individët që mendojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Aksesi i vëzhguesve të shoqërisë civile dhe KSHH-së në QV-të e vendit në përgjithësi ka qenë i mirë. Megjithatë u vërejtën disa probleme si p.sh. disa vëzhgues nuk janë lejuar nga komisioni i QV të asistojnë në procedurat e hapjes së votimit, ose nuk janë nxjerrë jashtë në momentet kur është pezulluar votimi, si në Tiranë QV 1797, 1410/2, 1410, në Librazhd QV 2706, në Vlorë QV 4473, etj. Vëzhguesit e KShH-së **kanë hasur pengesa në monitorimin e procesit të numërimit** dhe në disa raste nuk janë lejuar të hyjnë në vendet e numërimit të votave, pa dhënë asnjë arsye për këtë pengim, ku më problematike u paraqitën KZAZ nr. 32, 36 dhe 84.

Aksesi i medieve në procesin e votimit e të numërimit të votave ka qenë i mirë, por nuk kanë munguar dhe incidente, si ai me kameramanët dhe gazetarët e Top Channel. Mediet nga ana e tyre i kanë bërë pasqyrim të gjerë të gjithë veprimtarive të procesit të zgjedhjeve, duke përfshirë fushatën zgjedhore, ditën e votimit dhe numërimin e votave. Ato përveç hapësirave për të analizuar procesin me analistë të mirënjohur kanë ofruar hapësirë edhe për përfaqësues të shoqërisë civile që po monitorojnë këtë proces zgjedhor, duke u dhënë mundësi të flasin për konstatimet e tyre.

Një aspekt negativ i këtij procesi është dhe mungesa e transparencës së plotë të veprimtarisë së KQZ. Pasqyrimi i akteve të miratuara nga ky organ nuk ka qenë i plotë dhe në kohën e duhur, por probleme janë konstatuar, veçanërisht, lidhur me transparencën gjatë ditës së votimit dhe gjatë procesit të numërimit të votave.